

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2014

SESIONI I

VARIANTI A

E mërkurë, 18 qershor 2014

Ora 10.00

Lënda: Letërsi e thelluar

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20 pyetje**, 10 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe 10 pyetje me zhvillim.

Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Pikët									
Kërkesa	10a	10b	11a	11b	11c	11d	12	13	14
Pikët									
Kërkesa	15	16	17	18	19a	19b	19c	20	
Pikët									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Shekspir**Jul Qezar (Akti III, Skena II)****I Pari Qytetar**

Qëndroni! Dhe le ta dëgjojmë Antonin.

ANTONI

Me lejen e Mark Brutit, dal përpara jush.
(Ngjitet)

I PARI QYTETAR

Ky Jul Qezari ishte një tiran.

I TRETË QYTETAR

Po, pa dyshim; edhe të lumtur jemi
Që Roma ka shpëtuar prej këtij.

ANTONI

O miq, Romanë, qytetarë, më dëgjoni.
Vinj ta varros, jo ta lavdonj Qesarin
E keqja që ka bërë çdo njeri i mbetet.
E mira i mbulohet shpesh në varr me koskat.
Ashtu i qoftë dhe Qesarit. Trimi Brut
Ju tha tani, Qesari qe ambicioz.
Në paska qen' ashtu ashtu, qe faj i rëndë shumë
Dhe rëndë shumë e pagoj Qesari.
Këtu, pas lejes Brutit e të tjerëve, -
Se Bruti është burr' i nderçim,
Të nderçim janë që të gjithë, ay dhe shokët, -
Vinj që të flas në funeralin e Qesarit.
Ish miku im, më qe i drejtë dhe i besës.
Po Bruti thotë, qe ambicioz;
Dhe Bruti është burr' i nderçim.
Qesari i solli Romës shumë robër lufte
Dhe arkat me shpërblime ia ka mbushur.
Kjo qe ambicia e Qesarit? Si ju duket?
Qesari qante kur thërrisnin të vobektët.
Ambicia duhej t'ish me zemër më të ashpër.
Po Bruti thotë, qe ambicios,
Dhe Bruti është burr' i nderçim.
E patë që të gjithë se në Luperkalet
Tri her' i dhashë një kurorë mbretërore
Edhe tri her' e hodhi poshtë; qe ambicje kjo?
Po Bruti prapë thotë, qe ambicios,
Dhe është, pa dyshim, një burrë i nderçim.
S' dua të kundërshtoj ato që foli Bruti,
Po s' munt t'ju flas përveç ato që di.
Një her' e deshtë që të gjithë, - jo pa shkak;
Përse tani s'ju vjen asfare keq për të?
Nër egërsirat paske ikur, o gjykim,
Dhe njerëzit e paskan humbur arsyen!
Duron pak, se e kam zemrën te Qesari,
Aty, dhe pres sa të më kthehet prapë.

I PARI QYTETAR

Më duket që na flet me shumë arsye.

I DYTI QYTETAR

Po ta shikoni mirë punën, pati faj
Të madh Qesari

I TRETË QYTETAR

Ashtu kujtoni, zotërinj?
Kam frikë mos ia zër vendin një m'i lik.

I KATËRTI QYTETAR

E vutë re seç tha? E hodhi tej kurorën;
Ahere pa dyshim nuk ish ambicios.

I PARI QYTETAR

Në qoft' ashtu, disa do ta pagojnë shtrenjtë.

ANTONI

Gjer djethinaj një fjal' e Jul Qesarit
I bënte ballë botës; ja tani ku dergjet
Dhe s'ka njeri të vogël mjaft sa ta nderonjë.
O shokë, po të desha, munt t'ju ndisja zemrat
Sa t'ju tërboja e të bënit kryengritje,
Po do ta dëmtoja Brutin dhe Kasin, -
Që janë, siç e dini, njers të nderçim. -
S' dua ta bënj: më mirë i bëj dëm
Të vdekurit e vetes sim' e juve
Se sa këtyre njerësve të nderçim.
Po ja një pergamenë me vulën e Qesarit!
Ia gjeta në sëndyq; kjo është dhjat' e tij.
Po ta dëgjoni, qytetarë, këtë dhjatë, -
Që s'kam nër mënt t'jua këndonj, më ndjeni, -
Qesarit vdekur do t'ia puthnit plagët,
Në gjak të tij do ngjyenit shamitë;
Do lypnit për kujtim makar një qime
Dhe kur të vdisnit do t'ua linit djemve
Me testament si trashëgim të pasur.

QYTETARËT

Dhjatën! Dhjatën! Duam dhjatën e Qesarit.

1. Tragjedia “Jul Qezar” ka në qendër heronj: **1 pikë**
- A) të trilluar nga autori.
B) të marrë nga historia.
C) të marrë nga mitologjia.
D) të gojëdhënave romake.
2. Tragjedia trajton në subjektin e saj: **1 pikë**
- A) intrigat për pushtet pas vrasjes së Jul Qezarit.
B) përgatitjen e komplotit deri në vrasjen e Jul Qezarit.
C) fitoret e bujshme të Jul Qezarit në luftërat për pushtet.
D) përmbysjen e monarkisë nga republikanët dhe rikthimin e monarkisë.
3. Cila është ideja qendrore e këtij fragmenti? **1 pikë**
- A) Mark Antoni dëshiron të lejohet t’i bëjë Qezarit një varrim të denjë.
B) Mark Antoni vlerëson veprimet e Brutit dhe shpjegon arsyet pse u vra Qezari.
C) Mark Antoni përpiket ta manipulojë turmën për t’u ngritur kundër atyre që vranë Qezarin.
D) Mark Antoni kërkon ta prezantojë veten si sundimtarin e ri, në vend të Qezarit të vdekur.
4. Cilat aspekte të këtij fragmenti do të ishin më të dukshme nëse do ta shikonim në skenë këtë tragjedi në vend që ta lexonim? **1 pikë**
- A) Ndikimi i fjalimit të Mark Antonit te turma e qytetarëve.
B) Mënyra se si u vra Qezari dhe kush ishte përgjegjës.
C) Aftësitë e mëdha të Qezarit si sundimtar i Romës.
D) Dhimbja e thellë e Mark Antonit, ndërsa është duke mbajtur fjalimin.
5. Fjalimi i Mark Antonit hapet me: **1 pikë**
- A) apostrofë
B) pasthirmë
C) simbol
D) metaforë
6. Cili është qëllimi i mbajtjes së fjalimit të Mark Antonit përpara turmës? Analizoni mënyrën se si ai e arrin këtë. **3 pikë**

7. Identifikoni dy nga shembujt që sjell Mark Antoni përpara qytetarëve për të treguar se Qezari nuk ishte ambicioz. **2 pikë**

8. Çfarë përshtypje kërkon të krijojë Shekspiri në lidhje me karakterin e turmës në këtë fragment? Shpjegoni përgjigjen tuaj. **2 pikë**

9. Mark Antoni përsërit vazhdimisht se: “*Bruti është njeri i ndershëm*”. Çfarë toni përdor ai? Analizoni funksionin e këtij përdorimi. **3 pikë**

Toni: _____

Analiza: _____

10.

- a) Pse pikërisht, në këtë moment të fjalimit, Mark Antoni përmend testamentin e Qezarit? **1 pikë**

- b) Duke pasur parasysh vazhdimin e tragjedisë, shpjegoni pse ky fjalim është i rëndësishëm. **1 pikë**

Ismail Kadare

Kronikë në gur (fragment)

Në mëngjes ai u çua përsëri atje larg, i vetmuar dhe gri. Djegiet e natës së kaluar nuk kishin prishur asgjë në pamjen e tij të përgjithshme. Ishte larg, por gjithçka rreth e rrotull, malet, fshatrat, luginat kishin lidhje me fatin e tij. Një zjarr i tij ishte sinjal alarmi për të gjithë krahinën. Tani, gjysmë i braktisur, i ngjashëm me një qytet prehistorik, ku jeta ka pushuar prej kohësh, koracë e gurtë, gjysmë bosh, ai priste gjermanët.

Xhadeja, që do t'i sillte ata, (ashtu siç i kishte sjellë gjithë ushtritë), përpëlitej tani dhe kërkonte falje në këmbët e tij. Por ai, fisnik dhe mospërfillës si gjithmonë, as që i hidhte sytë. Dritaret e tij të turbullta vështronin larg.

Askush nuk e mori vesh në fillim atë që ndodhi në çastin kur pararoja e ushtrisë gjermane arriti në hyrjen e qytetit. Gjithçka u mor vesh më vonë. Pararoja u godit me pushkë dhe me bomba. Motoçiklistët që mbetën gjallë u kthyen mbrapsht si furtuna. Xhadeja mbeti për shumë kohë e shkretë. Ishte një heshtje e thellë. Qyteti, pasi bëri zakonin, priste me qetësi hakmarrjen.

Ata u dukën shumë shpejt. Këtë herë në krye ishin tanket. Xhadeja nxinte prej tyre. Tanket nuk u futën në qytet. Ato ndaluan në xhade dhe vetëm tytat e gjata të topave u rrotulluan ngadalë drejt qytetit. Gjermanët pritën një copë herë shfaqjen e flamurit të bardhë, shenja e dorëzimit të qytetit. Por gjithçka ishte gri.

Atëherë filloi bombardimi. Ishte një bombardim i rëndë, monoton. Zhurma e ndeshjes së hekurit me gurin, mbushi gjithë luginën. Copëra muresh e çatish, gjymtyrë ndërtesash e koka oxhaqesh, fluturonin nga të gjitha anët. Një pluhur i zi po mbulonte çdo gjë.

Bombardimi vazhdoi tri orë. Më në fund, midis grisë së vdekjes, dikush mundi të ngrejë diçka të bardhë. Kurrë nuk u mor vesh cili ishte njeriu që u ngjit si fantazmë mbi sipërfaqen e qytetit dhe u fundos sakaq, pasi lëkundit atë gjësend të bardhë në drejtim të gjermanëve. Nuk dihej ç' ishte ai send: flamur, shami apo thjesht një beze e zakonshme. Dihej vetëm se për një kohë të gjatë ajo gjë e bardhë do të terrorizonte mendjet e njerëzve.

Gjermanët që, mesa duket, përgjonin me dylbi nga shumë pika, e kapën menjëherë atë imazh, midis kaosit të tymit dhe të gërmadhëve. Bombardimi u ndërpre. Tanket rrotulluan tytat dhe nisën të ngjiten drejt qytetit. Çdo gjë dridhej. Zinxhirët duke u fërkuar me kalldrëmin, rënkonin, ulërinin, lëshonin xixa. Një rropamë skëterre mbushte gjithçka. Qyteti, pothuaj i braktisur, po pushtohej.

Më vonë u mor vesh, se në kohën që tanket po ngjiteshin duke ulëritur si përbindësh, nëpër rrugën e Urave të mëdha, nga dy dritare shtëpish, ishte bërë kjo bisedë midis hallë Xhemos dhe plakës së jetës Shano.

“Përse po bëjnë kaq zhurmë. Mund të hynin pak më me qetësi!” kish thënë hallë Xhemua.

Plaka Shano qe përgjegjur:

“Të gjithë ata bëjnë zhurmë e potere kur hyjnë. Vetëm kur ikin nuk ndihen”.

Kur muzgu ra, qyteti që kishte figuruar përkohësisht në hartat e Perandorisë Romake, të normandëve, të Bizantit, të Perandorisë Turke, të Mbretërisë së Greqisë, të Mbretërisë së Italisë, u ngrys këtë herë në Perandorinë e gjermanëve. I lodhur, krejt i trullësuar nga ndeshja, ai s'jepte asnjë shenjë jete.

12. Nisur nga konteksti, kur rrëfimtari thotë: “Një rropamë skëterre mbushte gjithçka.”, fjala rropamë do të thotë: **1 pikë**
- A) zhurmë
B) mizori
C) tërbim
D) përplasje
13. Në cilën prej alternativave të mëposhtme gjuha bëhet figurative? **1 pikë**
- A) Një zjarr i tillë ishte sinjal alarmi për të gjithë krahinën.
B) Nuk dihej ç’ ishte ai send: flamur, shami apo thjesht një beze e zakonshme.
C) Zinxhirët duke u fërkuar me kalldrëmin, rënkonin, ulërinin, lëshonin xixa.
D) Gjermanët pritën një copë herë shfaqjen e flamurit të bardhë, shenjë e dorëzimit të qytetit.
14. Toni me të cilin thuhet fjalët e mëposhtme është: **1 pikë**
- “Përse po bëjnë kaq zhurmë. Mund të hynin pak më me qetësi!” kish thënë hallë Xhemua.
- A) armiqësor
B) indiferent
C) ironik
D) nervoz
15. Në cilën nga alternativat e mëposhtme kemi epitete metaforik? **1 pikë**
- A) Xhadeja kërkonte falje në këmbët e tij.
B) Ishte një heshtje e thellë.
C) Një rropamë skëterre mbushte gjithçka.
D) Ajo gjë e bardhë do të terrorizonte mendjet e njerëzve.
16. Kur rrëfimtari thotë: “Zhurma e ndeshjes së hekurit me gurin, mbushi gjithë luginën”, ai nënkupton: **1 pikë**
- A) përplasjen e gjyleve të topave me shtëpitë e gurta.
B) largimin e zhurmshëm të banorëve nga qyteti.
C) zhurmën e makinave dhe motoçikletave që po hyjnë në qytet.
D) zhurmën që shkaktojnë hapat e ushtarëve në rrugë e qytetit.
17. Cili është personazhi kryesor në këtë fragment? Pse? **2 pikë**
-
-

18. Cilat janë dy nga arsyet që rrëfimtari përmend (në fund të fragmentit) një radhë perandorish? **2 pikë**

19.

a) Duke u mbështetur në *paragrafin I dhe II*, analizoni se çfarë ka të veçantë në mënyrën se si rrëfimtari e paraqet qytetin. **2 pikë**

b) Rrëfyesi e përmend disa herë përgjatë fragmentit ngjyrën gri. Zbërtheni nëntekstin që ajo mbart. **2 pikë**

c) Identifikoni në mënyrën se si bëhet përshkrimi i pushtimit të qytetit një rast ku ai është real dhe një rast kur ai merr ngjyrimet e tjera, të poetizuara. **2 pikë**

20. Interpretoni dialogun midis dy plakave, duke u mbështetur edhe në simbolikën që mbart përcaktimi që i bën rrëfimtari njëri prej tyre si *plaka e jetës*. **2 pikë**
